

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Autoritetit Kontraktues – KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **642-26-4062-5-1-1**

Sa i përket tenderit për Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kollovërt

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

HAXHA KOM SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Magjistratja Mitrovicë-Prishtinë p.n., Gojbulë

(Adresa)

VUSHTRRI

(Vendi)

42000

(Kodi postar)

045/222-552

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

GANI ZENULLAHI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

haxhakom@hotmail.com

(Adresa elektronike)

03.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit – 15.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim – 21.07.2026

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim (pjesërisht e bazuar) – 24.07.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 lidhur me nenin 27 dhe 28 të LPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

HYRJE

Pretendimi nr. 1 – Te kërkesat e DT lidhur me pajisjet, konkretisht te kërkesa 3,4,5 1215, 16, 18, 19 dhe 20 kufizohet pesha e pajisjeve edhe sa i përket minimumit por edhe maksimumit të peshës.

Kufizimi i peshës minimale është në rregull mirëpo kufizimi i peshës maksimale është totalisht diskriminuese/kufizuese. Ju lutem keni parasysh që rruga në fshatin Kollovërt për të cilën është shpallur ky aktivitet i prokurimit është një rrugë me terren të hapur dhe nuk ekziston asnjë pjesë e vetme ku pajisjet me pesha më të rënda mund të shkaktojnë ndonjë dëmtim. Përkundrazi, makineritë me peshë më të rëndë janë më të fuqishme dhe kanë përparësi shumë më të madhe në akse të tilla rrugore. Prandaj kufizimi i peshës maksimale të pajisjeve është jo vetëm e paligjshme por edhe e palogjikshme. Rrjedhimisht kërkojmë nga AK që për pajisjet sipas kërkesave më sipër të DT të largohet kufizimi për peshën maksimale pasi që mjafton që të kufizohet vetëm minimumi i peshës. Në rast se pajisja ka peshë më të madhe, atëherë kjo do të jetë më mirë dhe do të ketë më shumë përparësi për projektin dhe autoritetin kontraktues.

Pretendimi nr. 2 – Te pozicioni numër “3” te lista e paisjeve kërkohet : “Makine (speciale) për hapjen e kanaleve në tokë, max 13 ton”.

A mundet që të na e arsyetoni, pse kërkohet paisje “speciale” për hapjen e kanalit, e që këtë hapje të kanalit nuk mundet ta bëjmë me eskavatorë. Duke pasë parasyshë, se sipas paramasës, nuk kemi hapje të kanaleve fare, por vetëm germim të themeleve për ndërtimin e lëshesave gypore. Të gjitha shërbimet që mund të paramendohen se do të kryhen nga kjo makinë, mund të kryhen edhe përmes eskavatorëve të cilët e realizojnë tërësisht funksionin e njëjtë. Prandaj kërkojmë, që ky pozicion të largohet fare nga lista e paisjeve, sepse është kërkesë diskriminuese.

Pretendimi nr. 3 – Tek pozicionet 10, 12, 15, 16, 17 dhe 18 nga lista e paisjeve, kërkohen paisje për shtrimin e asfaltit.

Duke e analizuar paramasën e vërejmë, se sipas saj nuk ka fare shtrim të asfaltit (në këtë fazë të ndërtimit të kësaj rruge), e as gërryerje të asfaltit ekzistues. Prandaj, kërkojmë, që këto pozicione të largohen krejt prej listës së paisjeve, sepse janë të panevojshme dhe bien ndesh me paramasën.

Pretendimi nr. 4 – Te pozicioni numër 12, nga lista e paisjeve kërkohet: “Greder me sistem kontrollë automatike, ripera dhe ndalesa zhavori - max 12 Ton”

Kufizimi i peshës në max 12 ton, ashtu sic e cekëm më lartë bie ndesh me ligjin. Poashtu, specifikimi i kërkesave për grejder (sistem kontrollë automatike, ripera dhe ndalesa zhavori)

është kërkesë diskriminuese dhe favorizuese për OE të caktuar. A mundeni, ju lutem, që në mënyrë profesionale, ta arsyetoni se pse nuk mund të kryhet puna edhe me Grejder tjetër që nuk i posedon këto specifika të kërkuar, por që e plotëson kushtin e peshës?
Duke pasë parasyshë, se kjo kërkesë është diskriminuese, kërkojmë që të largohen specifikat e kërkuara për grejder, por të kërkohej vetëm grejder me peshë minimale të caktuar.

Pretendimi nr. 5 – Ky pretendim ka të bëjë me pozicionin 20 nga lista e paisjeve ku kërkohej: “Eskavator me grajther max. 750kg”.

Edhe të kjo pasije, kufizimi i peshës në max 750kg, bie ndesh me ligjin e prokurimit e poashtu me kushtet e punës në teren, ku sic e kemi cekur me lartë tereni është i hapur dhe mund të përdoren edhe eskavatorë më të mëdhenjë. Poashtu, kërkesa specifikuuese eskavator “me grejther” është diskriminuese dhe favorizuese për OE të caktuar, sepse nga paramasa e shohim, se nuk ka punë specifike, që mund të kryhen vetëm me paisje “speciale”, por janë punë të zakonshme, që kryhen me paisje, pa specifika speciale

Prandaj pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, kërkojmë nga ZPP që të merr këtë:

VENDIM

MIRATOHET SI E BAZUAR ankesa e OE “Haxha Kom Sh.P.K.” ashtu që aktiviteti i prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kollovërt” me nr. të prokurimit 642-26-4062-5-1-1 të shtyhet dhe të korigjohet lista e paisjeve.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të caktohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*